



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Data: 16.07.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për Ri-Shqyrtim të datës; 14.07.2025, të parashtruar nga "Arsimi Company SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja e infrastrukturës në qytet dhe fshatra" me nr. të Prokurimit 613-25-1158-2-1-1 Autoriteti kontraktues nxjerr:

## V E N D I M

**Refuzohet**, kërkesa për ri-shqyrtim, kërkesë e paraqitur më dt; 14.07.2025, nga "Arsimi Company SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:  
"Mirëmbajtja e infrastrukturës në qytet dhe fshatra" me nr. të Prokurimit 613-25-1158-2-1-1.

**Vërtetohet**, Njoftimi mbi Vendimin B58, i AK-së, i publikuar në platformen e prokurimit të datës: 09.07.2025.

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

## A r s y e t i m

Autoriteti kontraktues Komuna e Lipjanit ka pranuar kërkesë për Rishqyrtim më dt: 14.07.2025, për aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja e infrastrukturës në qytet dhe fshatra" me nr. të Prokurimit 613-25-1158-2-1-1, përmes sistemit elektronik në E-prokurim.

**Pergjigjeja në pretendimin e parë :**

Duke u bazuar ne kërkesat e AK ne njoftimin per kontrate si dhe dosje te tenderit kerkesa ka qene si ne vijim;

- a) **Min Nje inxhinier i ndertimtarise sistemi 5 vjeqar ose ( master) drejtimi konstruktiv min 5 vite pervoje pune pas diplomimit, te caktohet si menaxher i projektit.**

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar dhe bazuar në kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit, është vlerësuar se z.Agon Sadikaj i propozuar nga operatori ekonomik per kete pike, posedon diplomë Bachelor në sistemin 3-vjeçar dhe Master të përfunduar në vitin 2021.

Duke qenë se kërkesa e tenderit specifikon që përvoja minimale prej 5 viteve duhet të jetë pas diplomimit në sistemin 5-vjeçar ose Master, përvoja e ofruar nga viti 2017 nuk mund të merret parasysh pasiqe sistemi 5 vjeçar dhe bachelor nuk jane te njejte.

Diploma Master ne vitin 2021 e cila permbush kerkesen per nivelin e kerkuar te diplomimit, e qe përvoja e vlefshme në këtë rast fillon nga viti 2021 dhe deri në kohën e vlerësimit nuk i plotëson 5 vite të kërkuara sa i perket pervojes se punes pas diplomimit, e cila është kërkuar sipas kerkeseve në FTD.


Prandaj, eliminimi është bërë në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik neni 59, pasi kandidati nuk ka plotësuar kushtin për përvojën profesionale pas diplomimit në nivelin e kërkuar sipas kerkeses se AK ne njoftimin per kontrata si dhe dosje te tenderit.

**Pretendimi juaj është i pa bazuar.**

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lartë, më dt; 16.07.2025, ka vendosur si ne dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.

  
Drejtor i Prokurimit